



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

Datë :	05.07.2017
Referencë	11-344/6
Për :	Kryetar i Komunes- Imri Ahmeti
Përmes :	Drejtpërsëdrejti
Nga :	Drejtori i Drejtorisë të Inspektoratit - Imer Krustemi
Lënda :	RAPORTI MUJOR-QERSHOR



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT



Pasqyra tabelare e punës për muajin – QERSHOR

Inspektorët	Gjithsej	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje për kundërvajtje	Inspektime për pirjen e duhanit	Vërejtje, njoftime	Mbyllje e përkohëshme	Lëndë e ekzekutuara gjyqësore	Inspektime të përbashkëta	Pëlqime sanitare	Vendosje e shiritav zyrtar	Inspektim i auto-taxi	Menaxhim i tregjeve	Aktivndime- ndalesa,urdhëresa	Kërkesa, pune me palë	Gjoha mandatore	Inspektim i kafshëve në thetore	Inspektime me polici	Inspektim i tokave bujqësore	Biznese të pajegjistruara dhe pa pranime teknike	Malië me afat të skaduar
Biznesit	538	59	15			47			78				0	111	171			16		63	
Ambientit	263	20				4		7	98						131			3			
Bujqësisë	87	7				16			17						33				14		
Ndërtimtarisë	50	19		4					24					3							
Trafikut	516	45		7		132		2	63			147	10		62			48			
Sanitar	165	23		3	38	31		1	23	2					12		32				187€
Gjithsejtë	<u>1619</u>	<u>173</u>	<u>15</u>	<u>14</u>	<u>38</u>	<u>230</u>		<u>10</u>	<u>303</u>	<u>2</u>		<u>147</u>	<u>18</u>	<u>114</u>	<u>409</u>		<u>32</u>	<u>67</u>	<u>14</u>	<u>33</u>	<u>187€</u>

Gjatë muajit Qershor kemi hasur në 17 biznese të pa regjistruara në qendrën e regjistrimit të biznesit ku janë urdhëruar me procesverbal dhe me aktvendim që të bëjnë regjistrimin e tyre pranë qendresë së regjistrimit të bizneseve ARBK-së në Lipjan, gjithashtu kemi pasur 32 biznese pa pëlqim nga inspektorët e tregut për të ushtruar aktivitetin biznesor, ku janë urdhëruar me procesverbal dhe aktvendim që të aplikojnë pranë Drejtoratit të Inspektoratit tek Inspektorët e Tregut, në bazë të kërkesave të bizneseve kemi bërë pranime teknike me procesverbal për plotësimin e kushteve tekniko minimale për të ushtruar veprimtarin e tyre biznesore,

Është bërë inspektimi i disa subjekteve afariste, në veçanti kemi filluar me inspektimin e restoranteve, si dhe salloneve të ondulimit dhe zbukurimit. Nga Drejtoria e Inspektoratit është organizuar një aksion ku janë inspektuar marketet të ndryshme dhe gjatë inspektimit është gjetur mall me afat të skaduar në vlerë prej 187.1€, ndaj subjekteve ku është gjetur mall me afat të skaduar është bërë kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje.

Në thetore janë inspektuar kafshët për therje ku gjithsejt kanë qenë 32 kafshë.

Gjatë muajit qershor janë inspektuar disa fshatra dhe në qytet në bazë të ankesave të palëve dhe planit tonë, qëllimet e inspektimeve kishin të bëjnë me ndotjen e mjedisit në përgjithësi duke përfshirë ndotjen e ujit, tokës, ajrit dhe zhurmën.

Janë inspektuar parqet, pjesët e gjelbëruara të qytetit dhe vendgrumbullimet e mbeturinave në qytet dhe rrethinë.

Gjithashtu këtë muaj është punuar edhe rreth shqyrtimit të disa lëndëve si pjesë e komisionit për Lejen Mjedisore Komunale, ku një prej tyre është aprovuar dhe disa të tjera janë në procedure.

Kemi bërë inspektim të vazhdueshëm në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari“ në Vrellë ku kemi organizuar aksion në bashkëpunim me Policin kufitare të Aeroportit në lidhje me disa auto-taksi të cilët po tentojnë të ushtrojnë veprimtari ilegale, pra për ata të cilët i kemi hasur duke ushtruar veprimtari ilegale janë marr masat ndëshkimore në bazë të Ligjit. Po ashtu është bërë inspektimi në rrugën “ Skënderbeu“ ku janë inspektuar auto-taksit të cilët janë të vendosur në këtë rrugë .

Po ashtu gjatë këtij muajit në bashkëpunim me Policin e Kosovës njësia në Lipjan kemi bërë disa pika kontrolli në qytetin e Lipjanit ku janë inspektuar- kontrolluar edhe kompanitë e autobusëve të cilat operojnë në Komunën e Lipjanit në lidhje me rendin e udhëtimit se a janë duke e respektuar dhe është bërë kontrollimi për Licensë.

Gjatë këtij muaji janë inspektuar marketet ushqimore për produkte me prejardhje bimore, po ashtu janë inspektuar Tokat Bujqësore të cilat po mbushen me materiale të ndryshme si dhe atyre që po u nderohet destinimi.

Kemi pasur një aksion mbi kontrollin e hapësirave publike me drunj dekorativ mbi vedisimin e qytetareve për parandalimin e dëmtimeve që po u shkaktohet këtyre hapësirave. Janë bërë shqyrtime të aplikacioneve të fermerëve që kanë aplikuar për subvencione Komunale në Bujqësi

Për të gjitha parregullsitë është dhënë urdhër me procesverbale për evitimin e tyre, për çdo shkelje është vepruar konform ligjeve në fuqi.

Gjatë muajit Qershor janë inspektuar objekte të shumta e të ndryshme ndërtimi dhe inspektuar lokacionet e vend ndërtimeve në terren, gjendja e ndërtimeve është nënë kontrollin e vazhdueshëm inspektues në zonat urbane dhe zonat jo urbane, objekteve pa leje ndërtimi ka pasur të identifikuar, një (1) etazhi-mbindërtim të cilit i bërë Fletëparaqitje Penale e Fletëparaqitje për ndërtim pa leje, po ashtu edhe jashtë zonës së ndërtimit ka pasur ndërtim pa leje ndaj të cilit është shqiptuar Fletëparaqitje.